



**KËRKESAT E BE-së KUNDËR KORRUPSIONIT:
MATJA E PROGRESIT NË KOSOVË**

**EU ANTI-CORRUPTION REQUIREMENTS:
MEASURING PROGRESS IN KOSOVO**



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	2
2. METODOLOGJIA	3
3. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE	4
3.1. Administrata Publike	4
3.2. Legjislatura	8
3.3. Gjyqësori	12
4. REKOMANDIMET	17
5. HISTORIKU DHE METODOLOGJIA E CIMAP	19
6. FUSNOTAT	21

1. HYRJJE

Autoritetet e Kosovës vazhdimisht e kanë theksuar ambicien e vendit për t'u integruar në Bashkimin Evropian (BE). Megjithatë, BE-ja ka vendosur kritere për anëtarësim të cilat duhet t'i përmbushin Kosova dhe shtetet tjera që dëshirojnë të bashkohen. Ato përfshijnë përmbushjen e standardeve të caktuara financiare, ekonomike, sociale dhe politike, duke përfshirë standarde për korrupsion dhe qeverisje (të njohura në rajon si kriteret e Kopenhagës). Një tjetër çështje për Kosovën është mungesa e marrëdhënieve kontraktuese të vendit me BE-në, megjithëse zyrtarë të BE-së kanë siguruar autoritetet e Kosovës për perspektivën e vendit në BE. Kundër-korrupsioni është ndër kriteret më të rëndësishme që Kosova duhet t'i përmbush para se të merret parasysh për hyrje në BE.

Megjithatë, BE-ja nuk ka caktuar standarde të qarta për t'i vlerësuar ndryshimet kundër korrupsionit dhe në qeverisje. Në këtë mënyrë, ka qenë e vështirë të përcaktohet nëse shtetet kandidatë kanë avancuar dhe janë duke i përmbushur obligimet e tyre. Këto baza do të mundësojnë monitorimin e progresit – apo ngecjes – gjatë kohës. Gjithashtu, ato sigurojnë mjete për të vërtetuar nëse janë mbështetur dhe thelluar arritjet në qeverisje të një shteti. Mungesa e këtyre bazave ka nënkuptuar që synimi i përmbushjes së kërkesave të qeverisjes për anëtarësi në BE shpeshherë të duket si cak lëvizës për shtetet në fjalë.

Ky raport i përgjigjet kësaj nevojë duke caktuar bazën për vlerësimin e niveleve të qeverisjes së BE-së dhe shteteve potenciale kandidatë. Ai bazohet në rezultatet e nismës së Monitorimit Krahasues të bazuar në Indikatorë të Progresit Kundër Korrupsionit - Comparative Indicator-based Monitoring of Anti-corruption Progress - (CIMAP). Ky është një mjet monitorues që është formuluar nga Transparency International, bazuar në kërkesat për anëtarësi të BE-së për qeverisje dhe kundër-korrupsion, si dhe standardet e përgjithshme të praktikave të mira në këtë fushë. CIMAP është vlerësimi i parë i këtij lloji që do të kryhet për shtetet që pritet t'i bashkohen BE-së.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në Kosovë kundër korrupsionit, si shtetet që mund të ketë anëtarësi në të ardhmen. Kosova është zgjedhur për këtë studim bazuar në mundësinë e saj për anëtarësi dhe vështirësitë aktuale me të cilat përballlet në luftimin e korrupsionit, të identifikuar në disa tregues dhe studime.ⁱ

Progresi i vendit është vlerësuar bazuar në avancimet e bëra nga tri institucione të shtetit: gjyqësori, legjislatura dhe administrata publike (shërbimi civil). Të tri institucionet përbëjnë pjesë të tërësisë së qeverisjes të cilën BE-ja e shqyrton kur merr parasysh anëtarësinë e një shteti. Bazuar në përvojën dhe praktikën, këto tri institucione konsiderohen si komponentë thelbësorë për promovimin e masave kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Raporti tregon se në të gjitha katër shtetet ekziston një boshllëk i

përbashkët ndërmjet miratimi të ligjeve kundër korrupsionit dhe zbatimit të tyre. Ndonëse në shumë raste ekziston korniza ligjore dhe rregullative, ajo vazhdimisht nuk respektohet apo përdoret për të ndëshkuar papajtueshmërinë. Kapacitetet e ulëta dhe rezultatet e qeverisjes së dobët të shënuara për të tri institucionet ndihmojnë në shpjegimin e këtij vakumi ndërmjet ligjit dhe praktikës në secilin shtet. Gjetjet zbulojnë se nëse ekzistojnë boshllëqe të tilla, cenohet aftësia e institucioneve për performancë efektive të funksioneve të tyre kundër korrupsionit.

Në shqyrtimin e rezultateve, ekzistojnë të meta të përbashkëta të qeverisjes që paraqiten për të gjitha institucionet. Këto çështje të ndërlikdhura janë të vazhdueshme pavarësisht kontekstit të ndryshëm institucional apo shtetëror. Boshllëqet e identifikuar përfshijnë:

- Nivele të ulëta dhe jo të rregullta të qasjes në informata
- Aplikim joefektiv i detyrimeve për deklarim të pasurisë
- Mungesë apo moszbatueshmëri të kodeve të mirësjelljes
- Ndërhyrje politike në përgjegjësitë dhe operimet institucionale
- Kushte të dobëta të punës për gjyqtarët, stafin legjislativ dhe shërbyesit civilë.

Të përbashkëtat e këtyre problemeve sinjalizojnë nevojën për veprime të bashkërenduara nga ana e Kosovës në mbështetjen dhe realizimin e nismave që mund t'i zvogëlojnë boshllëqet e tilla. Që kjo të ndodh, vullneti politik është thelbësor për sa i përket lidershit të vendit. Nëse qeveria është përgjegjëse dhe proaktive, ajo mund të bëjë ndryshim të konsiderueshëm si në kuptim të reformimit ashtu dhe në zbatimin e politikave. Akterët ndërkombëtarë, ku BE-ja duhet të prijë, duhet t'i fuqizojnë këto përpjekje të udhëhequra nga shtetet.

Gjetjet e raportit i ofrojnë hisedarëve vendorë – përfshirë Komisionin Evropian, qeverinë dhe organizatat e shoqërisë civile – me një plan për mbylljen e të metave dhe përmbushjen e pjesëve kyçe të kriterëve për hyrje në BE.

Gjetjet bazohen në vlerësimin institucional të kryer në Kosovë duke përdorur indikatorë të standardizuar që mbulojnë ligjet kundër korrupsionit dhe zbatimin e tyre në praktikë. Indikatorët dalin nga kërkesat kundër korrupsionit për hyrje në BE dhe janë zhvilluar duke ndjekur një shqyrtim të hollësishëm të dokumentacionit që rregullon reformat që duhet ndërmarrë nga ana e Kosovës drejt anëtarësisë në BE. Si pikë referimi për zhvillimin e metodologjisë, është shfrytëzuar edhe metodologjia e Transparency International e Vlerësimit të Sistemit të Integritetit Shtetëror.ⁱⁱ

Nisma CIMAP është dizajnuar për të përcjellë dhe monitoruar ndryshimet gjatë kohës në institucionet e katër shteteve: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Turqi. Rezultatet e raportit përcaktojnë bazën që duhet të shfrytëzohet për të kryer vlerësime përcjellëse gjatë viteve në vijim.

2. METODOLOGJIA

Nisma CIMAP vlerëson performancën e tri institucioneve: gjyqësorit, legjislaturës dhe administratës publike.

Instituti Demokratik i Kosovës (sikurse organizatat e shoqërisë civile në secilin prej tri shteteve tjera) ka bashkëpunuar me Transparency International në grumbullimin e të dhënave për secilin institucion përmes:

- Analizës së ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera përkatëse zyrtare
- Rishqyrtimit të thellë të studimeve dhe informatave ekzistuese në dispozicion lidhur me temën
- Intervista kyçe me ekspertë lidhur me gjyqësorin, legjislaturën dhe administratën publike, si dhe me ata që punojnë në pozita relevante në institucione përkatëse.

Secili ekip shtetëror ka përdorur të njëjtit tregues dhe të njëjtën kornizë metodologjike për studimin. Përgjithësisht, janë vlerësuar më se 150 tregues në secilin shtet. Treguesit grupohen në katër tipare: kapaciteti, qeverisja, efektiviteti/efikasiteti i përgjithshëm dhe prokurimi publik. Gjatë shqyrtimit të gjetjeve të studimit, duhet të referohen përkufizimet dhe grupimet në vijim.

Kapaciteti

Kapaciteti i një institucioni vlerësohet duke i shikuar nivelet e resurseve dhe pavarësinë e përcaktuar me ligj dhe duke u bazuar në atë që ndodh në praktikë.

- **'Resurset'** kuptohet si disponueshmëria e inputeve të nevojshme që institucioni të funksionojë si në mënyrë efektive. Treguesit përkatës vlerësojnë resurset njerëzore, infrastrukturore dhe financiare të duhura, të cilat garantojnë me ligj dhe që sigurohen në praktikë.
- **'Pavarësia'** përfshin konceptin që institucioni ka aftësi të funksionojë pa ndërhyrje të papërshtatshme të jashtme nga institucionet tjera (përfshirë ekzekutivin) dhe me autonomi të mjaftueshme. Shembuj të treguesve që vlerësojnë pavarësinë institucionale përfshijnë nivelin e autonomisë buxhetore dhe dispozitat dhe praktikatat që sigurojnë punësim në baza meritore.

Qeverisja

Qeverisja e një institucioni përcaktohet përmes vlerësimit të nivele të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në pajtim me ligjet dhe zbatimin të tyre.

- **'Transparenca'** përfshin nivelin e sinçeritetit të një institucioni dhe, në veçanti, lehtësinë me të cilën qytetarët mund t'i uqasen informatave. Shembuj të treguesve që matin transparencën përfshijnë publikimin proaktiv të informatave lidhur me aktivitetet e një institucioni, qasjen fizike në institucione (gjykata dhe legjislaturë) dhe dispozitat dhe praktikatat lidhur me deklarimin e pasurisë.
- **'Llogaridhënia'** kuptohet si dispozitat dhe praktikatat që sigurojnë se institucioni dhe stafi i tij japin llogari dhe përgjigjen për veprimet dhe vendimet e tyre. Shembuj të treguesve për vlerësim të llogaridhënies

përfshijnë dispozitat dhe praktikatat e auditimit të brendshëm, si dhe ekzistimin e mekanizmave për ankimum.

- **'Integriteti'** do të thotë dispozitat dhe praktikatat institucionale që aderojnë praktikatat më të mira të parimeve etike. Shembuj të treguesve që përdoren për ta shqyrtuar integritetin institucional përfshijnë ekzistimin e kodeve të mirësjelljes dhe kodeve të etikës. Këto politika zakonisht trajtojnë kufizimet pas punësimit, dispozitat për konflikt të interesit, si dhe rregullimin e dhuratave dhe mikpritjes, mes tjerash.

Prokurimi publik

Treguesit janë përzgjedhur për studimin për të vlerësuar integritetin e sistemit publik të kontraktimit. Treguesit janë përfshirë në administratën publike së një shteti. Shembuj të treguesve janë se në çfarë niveli tenderimi i hapur konkurses përdoret si rregull i përgjithshëm, ekzistimi i organeve të pavarura rregullative dhe të mbikëqyrjes për monitorimin e prokurimit publik, si dhe ekzistimi i mekanizmave të drejtë të shqyrtimit dhe apelitit, mes tjerash.

Efikasiteti dhe efektiviteti

Treguesit përkatës janë shfrytëzuar në studim për të vlerësuar aftësinë e gjyqësorit dhe legjislaturës në ushtrimin e roleve të tyre në parandalimin e korrupsionit. Shembujt përfshijnë aftësinë e legjislaturës për t'i kontrolluar emërimet në pozitat ekzekutive, kompetencat e legjislaturës për të ndikuar dhe kontrolluar buxhetin e vendit, si dhe ekzistimin e dispozitave dhe praktikave për të shmangur vonesat e tepërta në lëndët e gjyqësorit.

Kategoritë e treguesve dalin nga përkufizimet e shfrytëzuara nga Transparency International si pjesë e vlerësimit të tyre të Sistemit të Integritetit të Vendit.

Secili tregues është përzgjedhur sipas kërkesave kundër korrupsionit që duhet përbushur nga ana e shteteve kandidate për BE. Ato janë përzgjedhur pas një shqyrtimi të hollësisht të dokumentacionit që rregullon reformat e BE-së dhe disa intervistave joformale me zyrtarë të Komisionit Evropian. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të treguesve janë marrë parasysh praktikatat më të mira ndërkombëtare në secilën nga këto tri fusha – gjyqësori, legjislatura dhe administrata publike.

Të gjithë treguesit janë notuar për të ndihmuar në saktësimin e të metave dhe përparësive në institucionet përkatëse. Notat vlerësojnë edhe kornizën përkatëse ligjore (ligjet dhe politikatat) edhe zbatimin e saj (praktikën). Secili tregues fillimisht notohet nga hulumtuesi me anë të notave 1-5 (nga performancë më e dobët deri të ajo më e forta). Këto nota pastaj janë mbledhur në një notë të përgjithshme për çdo dimension (p.sh. resurset, pavarësia, etj.). Kjo është bërë duke pjesëtuar notën e pranuar në notën maksimale që mund të caktohet, bazuar në përbushjen e shtetit të të gjitha kriterëve për hyrje në BE për një dimension të caktuar kundër korrupsionit. Kjo shifër pastaj është shndërruar në përqindje.

Koeficienti i barabartë është aplikuar për secilin tregues. Të gjitha notat e vendit janë vërtetuar nga ekspertë brenda shtetit përmes konsultimeve vendore. Informatat e përfshira në raport janë grumbulluar, analizuar dhe shqyrtuar ndërmjet nëntorit 2010 dhe prillit 2011. Për më shumë informata lidhur me metodologjinë, shihni Shtojcën 1.

3. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE


3.1 Administrata Publike

FIGURA 1

Rezultatet-notimet e CIMAP për Administratën publike

Shënim: Në ngjyrë të kuqe janë kategoritë me problemet madhore.

Këto kategori kanë marrë nota mesatare nën 49%.



Deri më 199, Kosova ka kaluar nëpër një shekull të konflikteve dhe funksionimit jonormal të qeverisjes. Me sa duket, kjo histori – deri në një masë – ka pasur ndikim në ndërtimin e deritanishëm të institucioneve në Kosovë. Administrata publike, siç do të tregojë studimi, është sektori me më së paku progresi për sa i përket përmbushjes së Standardeve Evropiane në praktikë.

Kapaciteti

Sektori me probleme madhore kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjit në praktikë është administrata publike. Në të vërtetë, është sektori me bazë më të mirë ligjore krahasuar me të tjerët. Në tri shtylla: Pavarësi, integritet dhe transparencë ka shënuar pikë maksimale me gati 100%. Megjithatë, është gjithashtu sektori që ka shënuar pikët më të ulëta në të tri shtyllat. Në praktikë, Administrata publike ka shënuar nën 60% në të 6 shtyllat e kapacitetit, qeverisjes dhe efektivitetit.

Fillon me një shpërndarje të pabarabartë të pagave, mes tjerash, të stafit politik dhe shërbyesve civilë.

Që nga prilli i vitit 2011, qeveria ka vendosur të ketë rritje të pagave me mesatarisht 23% në përgjithësi. Kjo rritje është negociuar një kohë të gjatë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili ishte këmbëngulës që të mos mbështes rritje prej 30% apo as 50% për të cilën synonte qeveria. Marrëveshja ndërmjet tyre ende nuk është arritur. Pavarësisht kësaj, shërbyesit civilë pranuar rritje të rrogave më 1 prill.

Situata ekonomike në Kosovë është përmirësuar paksa në

vitet e fundit, me rritje mesatare prej afro 4%. Indeksi i çmimeve të konsumatorëve është rritur në 115 pikë (2002=100) që është shkallë relativisht e ulët e inflacionit. Duhet të theksohet që, duke filluar nga 2000 deri 2008, në Kosovë ka pasur një trend të deflacionit. Viti 2008 ka përjetuar një shkallë mesatare të inflacionit prej 9%, gjersa më 2009 ishte 2.4%. më 2009, paga mesatare në Kosovë ishte afro 260 Euro. Që atëherë, është shënuar një rritja mesatare prej rreth 10%, sipas Bankës Qendrore të Kosovës.ⁱⁱⁱ

Një tjetër sfidë madhore për shërbimin civil të Kosovës është kapaciteti i resurseve njerëzore ku mungon ekspertiza dhe trajnimi i duhur. Raporti KIPA ka gjetur se pjesëmarrja e zyrtarëve në trajnime është e pamjaftueshme, kryesisht për shkak të trajnimeve të përsëritura në fusha të caktuara, si dhe për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të trajnimit në KIPA. Gjithashtu, KIPA ka mungesë të kapaciteteve dhe fondeve për të vepruar në pajtueshmëri me misionin e saj siç parashihet me mandatin e organizatës. Gjatë administratës së UNMIK-ut në Kosovë, ka pasur numër shumë më të madh të programeve të trajnimeve, kryesisht falë mbështetjes së donatorëve të mëdhenj, siç ishte GTZ.

Punësimi në baza meritore – siç saktësohet në ligjin për shërbimin civil – përcillet me boshllëqe madhore, kryesisht për shkak të nepotizmit dhe ndërhyrjeve politike. Ka pasur disa raste ku politika ka ndërhyrë në administratë publike. Rasti famëkeq i 8 sekretarëve të përhershëm që janë zëvendësuar me ndërhyrje të Kryeministrit është shembull i kësaj. Vëreni që pozita e Sekretarit të përhershëm është pozita më e lartë e shërbimit civil në një institucion. Është

menduar të sigurojë vazhdimësi të politikave brenda institucioneve, pavarësisht nga ndryshimet politike. Prandaj, caktimi i personave me lidhje politike në këto pozita është shkëlqje e rregulloreve të shërbimit civil.

Ligji i ri obligon institucionet që të ofrojnë mundësi të karrierës pikësëpari për të gjithë stafin e administratës publike, në rastet kur ka pozita të lira. Kjo praktikohet me qëllim të avancimit të individëve që janë të njohur me punën, para se të ftohen kandidatë të rinj pa njohuri të tilla. Me kohë kjo do të sigurojë pavarësi të shërbimit civil nga sektorët e tjerë, siç është politika. Deri më tani, dispozitat e Ligjit për shërbimin civil nuk janë respektuar në lidhje me këtë.^{iv}

Sipas Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, vetëm në vitin 2009 janë parashtruar 89 ankesa (apo 13% nga numri i përgjithshëm) në këtë institucion për të kundërshtuar një pozitë të lirë. Pavarësisht këtyre fakteve, këshilli ka qenë shumë i ngadaltë në shqyrtimin e ankesave nga shërbyesit e shkarkuar civilë, ndonëse pas dy deri tri viteve kur është nxjerrë vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës shërbyesit civilë kanë përfituar paga retroaktive. Në përgjithësi, sfida kryesore është mungesa e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, ndonëse vendimet administrative të KPM-së janë të pankimueshme.^v

ÇËSHTJET KRYESORE NË KAPACITETIN E QEVERISJES (TRANSPARENÇË, LLOGARIDHËNIE, INTEGRITET)

Ka ndëshkime shumë të buta për ata që nuk i deklarojnë pasuritë e tyre sipas ligjit, që kryesisht parashohin vetëm gjoba administrative.

Neni 16 përcakton që zyrtarët që shkelin Ligjin për deklarimin e pasurisë do të ndëshkohen deri në 1000 Euro për mosdeklarim të rregullt të pasurive çdo vit; deri në 500 Euro për mosdeklarim kur të fillojnë punën, deri në 1500 Euro për mosdeklarim me kërkesë të Agjencisë; deri në 500 Euro për mosdeklarim pas përfundimit të punës në atë funksion; për shkëlqje gjobiten subjektet që nuk veprojnë pas kërkesës së Agjencisë në pajtim me paragrafin 3 të nenit 14 të këtij ligji, me të cilin rast zyrtarët gjobiten në shumë prej 150-500 Euro.^{vi}

Gjithashtu, ligji nuk është i qartë se cilat masa duhet të ndërmerren në rast se AKK vërteton se një zyrtar i lartë publik ka falsifikuar deklaratimet e pasurisë. Për shembull, bordi i drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Pronës ka injoruar ftesën për deklarim të pasurisë.

Për sa i përket deklarimit të pasurisë, raporti vjetor i 2010 i AKK-së tregon se 1560 apo 95.7% të zyrtarëve të lartë i kanë deklaruar pasuritë e tyre në vitin 2010.^{vii} AKK ka verifikuar përputhshmërinë vetëm të 20% të të gjithë formularëve të ofruar nga zyrtarët publikë¹.

FLAMUR I KUQ

Transparenca dhe llogaridhënia e Administratës publike është në pikët më të ulëta të të gjithë treguesve të tjerë. Me notim prej vetëm 40% në llogaridhënie, Administrata publike konsiderohet si sektori me lidhjen më të ulët drejt publikut. Janë një varg strukturash organizative që nuk i përmbushin kërkesat ligjore, siç janë ato që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike. Zyrat në krye të ofrimit të qasjes në dokumente publike e vështirësojnë qasjen, apo e bëjnë atë të pamundur duke u thirrur në detyrime ligjore që i lejojnë institucionet të ruajnë “informata sekrete”.

Ligji për qasje në dokumente publike i ofron palëve të interesuara të drejtën në dokumentet publike, sipas specifikimeve në ligj. Duhet të ketë kërkesë me shkrim apo elektronike për qasje në këto dokumente dhe të gjitha të trajtohet në mënyrë të barabartë. Në vijim është nxjerrë urdhëresa administrative 2006/03 për zbatimin e këtij ligji. Nëse refuzohet, pala ka të drejtë të ankohet pranë Avokatit të Popullit. Gjithashtu parashihen ndëshkimet për institucionin që nuk vepron në përputhje (5000 – 10000 Euro), ndonëse nuk saktësohet se kush duhet ta paguajë atë: institucioni apo personi përgjegjës për ofrimin e informatës. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji në Kosovë vazhdon të jetë i dobët, qoftë për shkak të mosgatishmërisë institucionale për të lejuar qasje apo për shkak të mungesës së njohurisë së ligjit nga ana e zyrtarëve, në një anë, dhe mungesës së interesimit të qytetarëve për të drejtat e tyre të garantuara me këtë ligj, në anën tjetër.

Në përgjithësi, niveli i transparencës së institucioneve publike dhe informimi i duhur dhe në kohë i qytetarëve është i ulët. Kjo shihet edhe në rastin e mirëmbajtjes së faqeve të internetit nga ana e institucioneve. Shumica e dokumenteve publikohen javë apo muaj pas nxjerrjes së tyre. Kuvendi është shembull ku ligjeve dhe projektligjeve u duhen ditë apo, disa herë, muaj për t’u publikuar. Institucionet përmbahen nga publikimi i strategjive të caktuara që kanë implikime të mëdha buxhetore, siç kërkohet me ligj. Ky problem është i dukshëm në të gjitha institucionet, gjersa disa ministri nuk kanë fare strategji. Vetëm Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar strategjinë në faqe të internetit. Kërkesat për t’iu qasur strategjive të këtyre institucioneve kanë marrë përgjigje negative me arsye se nuk kanë miratuar fare strategji.

PROKURIMI PUBLIK

Proceset e tenderëve njëburimorë kanë qenë shqetësim për organizatat e shoqërisë civile dhe vetë Komisionin Evropian. Këto shqetësime janë shprehur në tri raportet e fundit të progresit të KE-së. Si në përgjigje në këtë kritikë, qeveria ka bërë përpjekje të ndryshojë ligjin për Prokurimin Publik në mënyrë të parregullt. Qeveria ka pretenduar ta rrisë përgjegjësinë në nivel politik, duke kërkuar nënshkrimin e kontratave nga së paku një pjesëtar i stafit politik. Në fund, kjo procedurë është anuluar në kuvend si jo e pajtueshme me procedurat e kuvendit për amendamentim. KRPP nuk mund ta monitorojë fazën e zbatimit të projekteve publike dhe Organi i Shqyrtimit të Prokurimit (OSHP) nuk i publikon në mënyrë sistematike vendimet e tij dhe ato shpeshherë kanë mungesë të argumenteve ligjore. Qeveria ka paraqitur draftin e ligjit të ri të prokurimit publik para Kuvendit. Dispozitat lidhur me koncesionet në kornizën aktuale ligjore ndryshojnë në masë të konsiderueshme me ato të acquis. Raporti është gjithashtu kritik ndaj Organit të Shqyrtimit të Prokurimit. Numri i kontratave të dhëna me procedurë të kufizuar u ul në zero në vitin 2010, ku procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit arrit 70.5 milionë Euro apo 11.2%. Megjithatë, e meta kryesore e prokurimit publik në Kosovë është zbatimi defektiv i legjisllacionit, që kryesisht është për shkak të korrupsionit dhe mungesës së përvojës nga kompanitë kosovare me legjisllacionin e prokurimit publik që e konsiderojnë atë si zhvillim i ri në ekonomi.^{viii}

Ka pasur shqetësime gjithnjë e më të mëdha lidhur me rritjen e numrit të kontratave njëburimore dhe kontratave me kushte të “çmimit ekonomikisht më të favorshëm”. Një gazetë ditore kishte sugjeruar që Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka dhënë kontrata te shokë të Ministrave dhe atë në çmim më të shtrenjtë.^{ix} Rasti i një kontrate është cekur si rast problematik, ku ndërtimi rrugor i vetëm 12 kilometrave i ka kushtuar buxhetit publik mesatarisht 23 milionë Euro. Megjithatë, ka pasur edhe raste ku kompanitë kanë ofruar çmim më të ulët dhe e kanë fituar kontratën, mirëpo nuk e kanë përmblyllur kontratën sipas kushteve të miratuara të kontratës.

GODITJA INSTITUCIONALE

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nuk mund të monitorojë zbatimin e projektit. Autoritetet kontraktuese kanë ofruar shumë pak asistencë në këtë pozicion. Për sa i përket Agjencisë së Prokurimit Publik, Raporti i progresit i KE-së për 2009 thekson se roli i saj si autoritet qendror është dobësuar përmes një mosvazhdimësie të përdorimit të saj në prokurimin qendror, përfshirë marrëveshjet kornizë.^x

Kapacitetet administrative të këtyre institucioneve janë dobësuar në masë të madhe nga ndërrimi i madh i zyrtarëve të prokurimit; zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbesin të cenueshëm ndaj ndërhyrjeve dhe kërcënimeve; të gjitha këto kanë ndikim negativ në cilësinë e prokurimit publik.

Organi i Shqyrtimit të Prokurimit ka shqyrtuar 585 ankesa nga të cilat 403 janë ankesa të parashtruara nga operatorë ekonomikë ndaj vendimeve të autoriteteve kontraktuese për dhënie të kontratës, dhe 155 janë kërkesa të autoriteteve të kontraktimit për shqyrtimin e vendimeve të AKK-së. Nga këto, janë shqyrtuar vetëm 331 ankesa në vitin 2010.^{xi}

FLAMUR I KUQ

Siç është cekur më herët në kuptim kuantitativ, prokurimi publik qëndron në bazë të shëndoshë ligjore, duke siguruar, mes tjerash, edhe transparencën. LPP ka rregulla të zhvilluara mirë për shpalljet dhe transparencën, ku autoriteti kontraktues duhet të shpall njoftimin indikativ nëse synon dhënien e një kontrate me vlerë prej më shumë se 250,000 Euro...^{xii}

Shpalljet duhet të jenë në shqip dhe serbisht, si dhe për kontrata të vlerës së madhe edhe në anglisht, nëse konsiderohet se është e nevojshme. Shpalljet dërgohen në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), i cili i publikon ato në të gjitha gjuhët, si në faqe të internetit ashtu dhe në Regjistrin e Prokurimit Publik.


Megjithatë, nuk është e qartë nëse publikimet e kërkuara me ligj bëhen rregullisht. Përkundër faktit që të gjitha autoritetet kontraktuese obligohen t'i paraqesin planet e tyre të prokurimit në APP së paku 60 ditë para vitit fiskal (nëntor), shumica e këtyre planeve të prokurimit nuk publikohen, përveç shpalljeve indikative (të cilat zakonisht janë tenderë voluminozë që kërkojnë që operatorët ekonomikë (OE-të) të përgatiten me aspekte të mëdha teknike). Kjo praktikë zakonisht bëhet për të shkurtuar kohën për dhënie të kontratës. Kontrata më e madhe që është dhënë nga ky institucion, autostrada Vermicë-Merdare për ndërmarrjen Bechtel&Enka, nuk është publikuar, sikurse që nuk janë publikuar arsyet për dhënien e saj te konsorciumi në fjalë.^{xiii}

3.2 LEGJISLATURA

FIGURA 1

Rezultatet-notimet e CIMAP për Legjislaturën

Shënim: Me të kuqe janë kategoritë me probleme të mëdha.



Nëse pakoja ligjore është pengesë për funksionimin e mirë të legjislaturës, kush duhet të fajësohet? Një nga boshllëqet më të mëdha për legjislaturë transparente, llogaridhënëse dhe efikase është vetë legjislacioni i krijuar në Kuvendin e Kosovës. Ky legjislacion ka mungesë të mjeteve të zbatimit për të nxitur kryesinë e Kuvendit që të ofrojë infrastrukturë dhe resurse të nevojshme për administratën, komisionet dhe sektorët e tjerë.

Kapaciteti

Komisionet parlamentare përballen me mungesë të kapacitetit të absorbimit për shpenzimin e fondeve të ndara në mënyrë të planifikuar, si dhe mungesë të ekspertizës për ligjbërje në përgjithësi. Ky institucion ka mungesë të kapaciteteve administrative dhe teknike të komisioneve, në të avancuar më tej drejt mbikëqyrjes parlamentare të degës së ekzekutivit të qeverisë. Mosefikasiteti i komisioneve parlamentare është i dukshëm, kryesisht për shkak të mungesës së stafit profesional. Shumica e Koordinatorëve të komisioneve janë në prag të pensionimit dhe rigjenerimi i këtyre pozitave nuk ka shkuar siç është pritur.^{xiv}

ZYRAT DHE STAFI I KUALIFIKUAR

FIGURA 1

Rezultatet-notimet e CIMAP për Legjislaturën

Shënim: Me të kuqe janë kategoritë me probleme të mëdha. Këto kategori kanë marrë notë mesatare nën 60%.



Nuk ka zyra individuale për deputetët. Veç kësaj, deputetët nuk kanë asistentë personalë dhe nevojat e tyre mund të përmbushen vetëm duke shfrytëzuar Zyrat Qendrore të Grupeve Parlamentare dhe stafit brenda Ndërtesës së Kuvendit. Stafit administrativ i Kuvendit mbështetet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, ku rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë NDI, GTZ dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

BUXHETI

Buxheti i ndarë për Kuvendin e Republikës për vitin 2011 është ulur nga 9,524,580 në 8,867,921 Euro

Kufizimet e FMN

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vendosur kufizime në shpenzimet e stafit të kuvendit, ku numri i përgjithshëm i stafit nuk mund të tejkalojë 157. Në këtë kuptim, sekretariati ka vendosur të shkarkojë pjesëtarët e sigurimit nga stafi i kuvendit dhe të kontrktojë kompani për pastrim dhe sigurim. Kjo i ka dhënë sekretariatit mundësinë që të shtojë numrin e stafit profesional në administratën e Kuvendit. Aktualisht numri i të punësuarve është 167.^{xv}

PAVARËSIA – PËRBALLJA ME STRATEGJINË LEGJISLATIVE

Një nga sfidat kryesore për Kuvendin është dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me agjendën e saj. Qeveria është pjesërisht me faj për këtë gjë, e cila ngurron të parashtrojë projektligje sipas strategjisë legjislative.^{xvi} Kuvendi nuk e harton strategjinë legjislative. Qeveria ka strategji të saj, dhe agjenda e Kuvendit varet në masë të madhe nga ajo. Qeveria është përgjegjëse për vendosjen e strategjisë legjislative për vitin pasues. Prandaj, një nga problemet kryesore për ku-

vendin është pamundësia e tij që të negociojë me qeverinë strategjinë legjislative, që përbën pjesën madhore të punës së Kuvendit (krahas mbikëqyrjes së qeverisë). Gjithashtu, kjo prek cilësinë e ligjeve të miratuara nga Kuvendi, posaçërisht atij të buxhetit të vendit. Megjithatë, çështjet tjera parlamentare siç janë pyetjet parlamentare, takimet e komisioneve dhe kontrolli i qeverisë realizohen mirë nga kuvendi.

Qeverisja

SINQERITETI NDAJ OPINIONIT PUBLIK MBETET ÇËSHTJE PËR KUVENDIN

Gjatë seancave plenare, gazetarët lejohen të mbesin në dhomë vetëm për 5 minuta, kryesisht për shkak të hapësirës së pamjaftueshme në objektet e Kuvendit. Megjithatë, gazetarët mund ta marrin informatën e nevojshme përmes televizionit publik (RTK). Seancat plenare nuk transmetohen pas orës 17:00, dhe kjo përbën shqetësim për ata që konsiderojnë se ato informata janë të nevojshme.

Në anën tjetër, për sa i përket seancave të Komisionit, janë 5 apo 6 ulëse të rezervuara për publikun dhe mediat, që në shumicën e rasteve nuk mjafton. Megjithatë, takimet e Komisioneve zakonisht janë të hapura për publikun dhe mediat. Përkundër faktit që Rregullorja e Punës nuk trajton saktësisht çështjen e transparencës në procedurën e Komisionit, dhe përkundër mungesës së transkripteve për publikun, takimet e Presidencës së Kuvendit vazhdojnë të mbesin në dyer të mbyllura për organizatat e shoqërisë civile, gjersa janë të hapura për institucione e organizata ndërkombëtare si Misioni i OSBE-së, Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) apo Instituti Nacional Demokratik (NDI). Kjo paraqet shqetësim të rëndë që është trajtuar me ngulm nga monitoruesit e kuvendit.^{xvii}

FLAMUR I KUQ

QASJA NË “DOKUMENTET E KUVENDIT”

Dispozitat ligjore janë të paqarta kur kemi të bëjmë me kërkesat për publikimin e dokumenteve zyrtare nga ana e Kuvendit, siç janë raportet mbi aktivitetet e tij, si dhe projektligjet. Ekziston një vendim i brendshëm i kryesisë që kërkon publikimin e projektligjeve dhe disa raporteve periodike të komisioneve. Ligji për Qasje në dokumentet zyrtare obligon institucionet që me vetë-iniciativë “të publikojnë çdo gjë që mund të publikohet, e që është hartuar nga institucioni, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Pika 2.3 dhe 2.4 të këtij neni obligojnë institucionet që t’i publikojnë në faqet e tyre të internetit “legjislacionin bazik të organizatës, funksionimin dhe funksionet e institucionit në fjalë”, si dhe të dhënat e azhuruara lidhur me aktivitetin publik, politikat, aktet ligjore dhe aktet nënligjore të institucionit në fjalë”.^{xviii}

Në praktikë, shumë pak projektligje publikohen në faqen e internetit të Kuvendit gjatë kohës së dëgjimit të tyre. Gjithashtu, ka raste të rralla kur mund të merret kopje fizike e një projektligji nga deputetët apo administrata në këtë kohë. Projektligjet publikohet vetëm pasi që të iu ketë dashur më shumë se një muaj për aprovim nga ana e kuvendit.

RAPORTIMI FINANCIAR SI MASË DREJT INTEGRITETIT

Përgjithësisht, rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm merren parasysh nga ana e Kuvendit, posaçërisht pas skandalit famëkeq, ku një ish kryetar kuvendi ishte i përfshirë në keqmenaxhimin e fondeve publike. Ligji për Auditorin e Përgjithshëm kërkon nga institucioni që “brenda 30 ditëve pas publikimit të raportit përkatës të auditimit, institucioni apo subjekti i audituar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni t’i dorëzojë Auditorit të Përgjithshëm raportin që tregon se në çfarë mënyre institucioni apo subjekti synon t’i zbatojë rekomandimet e bëra në raportin e auditimit”. Raporti vjetor i Auditorit të Përgjithshëm i ka dhënë tetë rekomandime për Kuvendin, ku:

Pesë prej tyre janë trajtuar në tërësi; dy prej tyre janë trajtuar pjesërisht;

Një prej tyre nuk është trajtuar fare, e ajo ishte: “*Të bëhet një analizë e detajuar për secilin planifikim buxhetor në pajtim me linjat buxhetore dhe vlerat specifike në mënyrë që shpenzimet buxhetore të jenë në pajtueshmëri me planifikimin e vërtetë buxhetor. Planifikimi për nevoja buxhetore duhet të përmirësohet, si dhe të monitorohet*”.^{xix}

LOBIMI NË KUVENDIN E KOSOVËS ËSHTË JOLIGJOR

Sipas Kodit të Mirësjelljes, pika 5, avokimi dhe lobimi i paguar në Kuvend ndalohet për të gjithë Deputetët. Deputetët nuk guxojnë të nisin apo të ndikon rrjedhat e diskutimeve apo çështjeve në Kuvend apo takime të Komisioneve, në këmbim për pagesë apo lloje tjera të përfitimeve, direkte apo indirekte. E njëjta aplikohet në pagesat apo përfitimet e pranuar nga anëtarët e ngushtë të familjes së një Deputeti. Veç kësaj, një nga gjetjet interesante të CIMAP është se shpjegimi i mësipërm nuk e rregullon çështjen e lobimit në kuvend, kryesisht për shkak se deputetët nuk obligohen me ligj t’i shpalosin kontaktet e tyre me lobistët, dhe lobimi nuk është aktivitet i njohur shumë në Kosovë.

DEKLARIMI I PASURISË DHE DHURATAVE NGA ANA E DEPUTETËVE

Ligji për deklarimin e pasurisë dhe prejardhjen e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të lartë publikë përcakton se të gjithë zyrtarët e lartë janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë e tyre dhe dhuratat, si dhe prejardhjen e tyre.

Ligji i referohet deputetëve si zyrtarë të lartë publikë; megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e të afërmeve të këtyre Zyrtarëve të lartë publikë obligohen t’i nënshtrohen deklarimit të pasurisë. Ai përfshin vetëm anëtarët e familjes të cekur si bashkëshorti dhe fëmijët e Zyrtarëve të lartë publikë. Ndryshe, kjo do të thotë se në rast të një hetimi, AKK mund t’i bëjë subjekte vetëm ata individë, që le hapësirë për zyrtarët t’i fshehin fitimet e tyre joligjore.^{xx}

Më 24 mars të këtij viti, Agjencia Kundër Korrupsionit prezantoi raportin vjetor të vitit 2010. Raporti prezantoi një metodologji të kontrollit që përdoret për të dëshmuar saktësinë dhe besueshmërinë e formularëve të plotësuar nga zyrtarët e lartë publikë.^{xxi} Kontrollimi i formularëve të deklarimit përfshin: a) Kontrollin fillestar, që përfshin të gjithë formularët e plotësuar nga zyrtarët publikë, që ka për qëllim evidentimin e gabimeve materiale dhe gabimeve të tjera. Nga 120 deputetë, 22 formularë janë kontrolluar nga AKK-ja në këtë fazë; b) Kontrolli i plotë, që kryhet për të gjithë formularët, si dhe synon krahasimin e deklarimit aktual me atë të vitit paraqar; nga 120 deputetë, AKK-ja i ka përcjellë 12 raste për hetime të mëtejme në Njësinë e Inteligjencës Financiare. AKK ishte në gjendje të verifikojë rregullsinë e vetëm 20% të numrit të përgjithshëm të formularëve të deklarimit, duke përfshirë të gjithë zyrtarët më të lartë (deputetët, ministrat, gjyqtarët, etj.).

Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit bashkëpunon me një numër institucionesh tjerash gjatë kryerjes së kësaj procedure, mes tjerash edhe me Njësinë për Inteligjencë Financiare, Zyra Disiplinore e Prokurorit, si dhe Njësia për Hetime të Krimin të Organizuar në EULEX.

Efikasiteti

NDIKIMI BUXHETOR I KUVENDIT

Edhe pse sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi miraton buxhetin, sipas Ministrisë së Financave, Kuvendi ka rol të kufizuar, por të rëndësishëm në procesin buxhetor, përmes Udhëzimeve mbi Procesin dhe Planifikimin e Buxhetit të Kosovës. Këto udhëzime gjithashtu theksojnë që Kuvendi ka mundësi të kufizuar të vendosë mbi formën, madhësinë dhe orientimin e buxhetit.^{xxii} Pra, autoritetet duhet të përdorin një klasifikim transparent të kategorive të shpenzimeve kur i dorëzojnë buxhetin Kuvendit. Dallimet duhen zgjidhur me transparencë, me një vendim të veçantë mbi atë se si duhen klasifikuar linjat e memorandumit si rezervat fiskale dhe huat për ndërmarrje publike.^{xxiii}

Duhet përmendur edhe themelimi i Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike më 2009. Ky Komision shqyrton raportet e auditimit për gjitha institucionet, pra kjo shënohet si përparim në mbikëqyrjen e shpenzimeve të buxhetit publik nga institucionet publike. Megjithatë, ky Komisioni ka kompetenca vetëm për trajtimin e raporteve të Auditorit të Përgjithshëm.


3.3 GJYQËSORI

FIGURA 3

Vlerësimi sipas Kriteve të BE - Gjyqësori

Burimi: Të dhënat sipas notave të vendit: Shtojca 2.

Shënim: Me të kuqe janë kategoritë me probleme të mëdha. Këto kategori kanë marrë notë mesatare nën 58%.



Nëse kontrolli reciprok garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ekzistojnë së paku tre sektorë me pushtet të barabartë, por të veçantë për të siguruar një gjendje të tillë. Duke marrë parasysh gjyqësorin e dobët, mund të përfundohet që kontrollet dhe kundërpeshat nuk janë të siguruar në sistemin kosovar të qeverisjes. Ka shumë arsye për këtë, por një që theksohet më së shumti është mungesa e vullnetit politik për të siguruar resurset dhe infrastrukturën e nevojshme për gjyqësorin në Kosovë. Një prej pasojave kryesore të kësaj anomalie sistemore është pamundësia e tij që të parandalojë sjelljen korruptive të vetë anëtarëve të tij. Ndoshta, kjo mund të jetë një prej arsyeve që politikanët ngurrojnë të përforcojnë këtë sektor.

Kapaciteti

BUXHET I VOGËL – ME PËRMIRËSIM TË PAGAVE PËR GJYQTARË

Buxheti i përgjithshëm i gjyqësorit është afërsisht 1.5% të buxhetit total të Kosovës. Ai nuk ka ndjekur asnjëherë prirjet buxhetore të institucioneve tjera gjatë dhjetë viteve të fundit. Për më tepër, pas Doganave të Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kontribuuesi i tretë më i madh në buxhetin publik.^{xxiv}

Gjyqësori përballet me buxhet të pamjaftueshëm për të kryer detyrat e veta në mënyrë efektive. Atij i mungon infrastruktura adekuate, derisa gjyqtarët shpesh detyrohen të punojnë në zyra tejet të vogla, të cilat nuk janë të përshtat-

shme për të kryer detyrat e tyre. Gjykatat kanë edhe mungesë të resurseve njerëzore dhe financiare. Gjyqësorit i mungojnë edhe resurse tjera, si bibliotekat, personeli administrativ me përvojë, si dhe qëndrueshmëria e resurseve njerëzore. Ka raste kur gjyqtarët anulojnë seancat dëgjimore për shkak të mungesës së gjykatoreve në dispozicion. Nuk është i rrallë as rasti kur gjyqtarët i mbajnë dëgjimet në zyrat e tyre.

Ligji i ri mbi Gjykatat (dispozitat për paga të të cilit kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2011) përcakton që Gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të kenë paga ekuivalente me një ministër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për më tepër, Kryetari i Gjykatës Supreme do të ketë pagën e barabartë me atë të Kryeministrit.^{xxv}

Ky ligj gjithashtu përcakton që secili gjyqtar i Gjykatës Bazë do të marrë pagën bazë prej jo më pak sesa 70% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Bazë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të bëjë një listë të kompensimeve tjera në lidhje me përgjegjësitë e veçanta të gjyqtarëve që shërbejnë në krimet e rënda, çështjet komerciale apo konfliktet administrative; por, në asnjë rast, shumica e rrogës bazë dhe kompensimeve shtesë nuk mund të tejkalojë 90% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Bazë.^{xxvi}

MENAXHIMI I BUXHETIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i autorizuar (si përfaqësues i gjitha gjykatave të Kosovës) që të përgatisë dhe dorëzojë propozimin e buxhetit dhe kërkesat tjera financiare në përputhje me këtë ligj. KGJK-ja i propozon Qeverisë buxhetin gjyqësor, por përjashtohet nga vendim-marrja në këtë proces, sepse vendimi përfundimtar merret nga MEF-i dhe Kuvendi i Kosovës.^{xxvii}

Megjithatë, duke marrë parasysh që gjyqësori – përmes llogarive të KGJK-së – kontribuon një pjesë të madhe të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe rezervave shtetërore, rezultati përfundimtar është që gjyqësori nuk ka të drejtë të organizojë vetë buxhetin e tij. Prania e KGJK-së në Komisionin e Buxhetit në Kuvend konsiderohet obligim tejet i rëndësishëm që Kuvendi duhet ta ketë. Deri tani, diskutimet për buxhetin janë bërë vetëm me Ministrinë e Financave, derisa ka qenë e pamundur të mundësohet kjo prani gjatë dëgjimeve buxhetore, për shkak që nuk janë marrë ftesa nga kuvendi.^{xxviii}

PUSHTETI DHE AUTORITETI I GJYKATAVE

Sipas Kushtetutës së Republikës, gjitha palët (Presidenti apo Kryeministri, si dhe Qeveria sipas rregulloreve) kanë të drejtë t'i referojnë kësaj Gjykate lëndët në lidhje me kushtetutshmërinë e akteve ligjore dhe rregulloreve, si dhe përputhshmërinë me Kushtetutën të statuteve komunale, derisa gjithashtu përcaktohet që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës si dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën.

Në dritën e këtyre dispozitave, më 28 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi që Presidenti kishte kryer shkelje të Kushtetutës duke mbajtur dy poste, atë të presidentit të vendit si dhe kryetarit të partisë në të njëjtën kohë. Vendimi erdhi pasi deputeti Z. Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë tjerë kërkuan nga Gjykata të interpretojë Kushtetutën në rastin e pozitës së Presidentit. Rrjedhimisht, Presidenti dha dorëheqje më 27 shtator, një ditë pas publikimit të verdiktit.^{xxix} Gjykata gjithashtu vendosi që procedura e zgjedhjes së Presidentit nga Kuvendi, në rastin e Z. Behxhet Pacolli, ishte jokushtetuese. Vijimisht, edhe Pacolli u desh të jepte dorëheqje.

EMËRIMI OBJEKTIV, NË BAZA MERITORE, SI DHE ZHVILLIMI I KARRIERËS SË GJYQITARËVE

Kushtetuta e Kosovës përcakton bazën ligjore për themelimin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij [...] Këshilli Gjyqësor i Kosovës jep preferencat e veta në pro-

cesin e emërimit të gjyqtarëve për anëtarët e Komuniteteve të cilat janë më pak të përfaqësuar në gjyqësor, në përputhje me ligjin.

Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim në pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është gjithashtu përgjegjës për procedurat e transferimit dhe ato disiplinore për gjyqtarë.^{xxx}

Megjithatë, nuk ka informata që ofrohen nga KGJK-ja apo Instituti Gjyqësor i Kosovës për këtë çështje, as në internet e as në ndonjë raport të botuar nga KGJK-ja. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë është mbajtur më 2010, kur është mbajtur testi i etikës. Ky proces ka marrë mjaft shumë kohë, si dhe ka pasur një numër të madh verifikuesish e hetuesish që janë angazhuar në proces. Ka pasur edhe raste dështimi në procesin e përzgjedhjes nga Këshilli. Një çështje tjetër ka qenë edhe përzgjedhja e kandidatëve nga nivelet e ulëta të gjyqësorit për pozita shumë më të larta (si nga Gjykata Komunale në Gjykatën Supreme).^{xxxi}

BAZAT PËR VEPRIME DISIPLINORE KUNDËR GJYQITARËVE, TË KUFIZUARA DHE DEFINUARA ME LIGJ

Zyra e Prokurorit Disiplinor i ka dërguar KGJK-së gjithsej 77 raste për procedura disiplinore. Disa gjyqtarë janë ankuar tek Gjykata Supreme, për shkarkimin e tyre nga pozitat për shkak të dështimit në provimin e jurisprudencës.^{xxxii} Kushtetuta i lejon gjyqtarëve të apelojnë vendimin për shkarkim direkt tek Gjykata Supreme e Kosovës.

Zakonisht, KGJK-ja publikon rastet e dorëheqjes dhe suspendimit të gjyqtarëve. Megjithatë, rrallë ndodh që gjyqtarë të shkarkohen nga pozitat para përfundimit të mandatit të tyre. Nëse do ta krahasonim këtë me shkeljet e raportuara, kjo do të duhej të ndodhte më shpesh.

Nuk ka informata mbi këtë çështje të publikuara nga Gjykata Supreme. Që nga viti 2001, Zyra e Prokurorit Disiplinor i ka dërguar një numër të madh ankesash Këshillit Gjyqësor të Kosovës (293 vetëm në vitin 2009). Megjithatë, janë ende më shumë se njëqind raste që mbesin nën hetime, kryesisht për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të KGJK-së për t'i absorbuar ato, si dhe për të marrë vendime për gjyqtarët dhe prokurorët e kontestuar. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë tejet joefikas në këtë çështje, si dhe kjo tregohet nga numri i gjyqtarëve të suspenduar, i cili numër është 10 deri tani. Mungesa e menaxhimit të mjaftueshëm gjyqësor duket të jetë çështje qenësore për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Ky menaxhim i dobët është infrastrukturë atraktive për gjyqtarë të korruptuar dhe të afërm të tyre për veprimin e tyre në Kosovë.^{xxxiii}

Gjithashtu, çështja e imunitetit të gjyqtarëve nuk është qartësisht e definuar me ligjet e miratuara nga Parlamenti. I vetmi dokument që rregullon këtë çështje ende mbetet Kushtetuta. Në Ligjin mbi Gjykatat, përcaktohet vetëm që gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë kanë imunitet vetëm aq sa përcaktohet me Kushtetutë. Zakonisht ka ankesa që i dorëzohen gjykatave, të cilat shprehin pakënaqësinë e një pale. Megjithatë, është e zakonshme që këto raste të hedhen poshtë, për shkak të mungesës së provave të besueshme, si dhe duke marrë parasysh edhe arsyetimin e dhënë nga Gjyqtari.

NDARJA E RASTEVE NË BAZË TË KRITEREVE OBJEKTIVE

Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (CMIS) është ndërtuar për ndihmë teknike për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në procesin e automatizimit të punës në gjitha gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Ky program automatikisht bën regjistrimin e lëndëve; analizimin e lëndës; kalendarin dhe afatet; seancat dhe procesverbalet; akt-gjykimet dhe zgjidhjen e rasteve; apelet dhe ankesat; mjetet e jashtëzakonshme juridike; përmbarimin; arkivimin.^{xxxiv}

Gjykatat në gjithë Kosovën janë pajisur me kompjuterë të rinj, dhe kjo do të duhej të kishte mundësuar instalimin e programit për sistemin informativ të menaxhimit në gjykata, si dhe regjistrimin e të dhënave dhe rasteve nga regjistrat e vjetër në sistem. Megjithatë, sistemi ende nuk është plotësisht funksional, kryesisht për shkak të mungesës së rrjeteve dhe kompjuterëve në disa gjykata. Rastet ende ndahen mes gjyqtarëve me short.

Qeverisja

STANDARDET E TIKE PËR GJYQTARË NUK RESPEKTOHEN

Zyra e Prokurorit Disiplinor ka marrë disa masa kundër gjyqtarëve që kanë shkelur kodin e etikës. Këto masa bazohen në urdhëresën administrative 2006/8, e cila përshkruan shkeljet dhe sjelljen e pahijshme të gjyqtarëve, të cilat janë:

Kryerja e një vepre penale; neglizhimi i funksionit të gjyqtarit/prokurorit; veprimet që nuk janë në përputhje me mandatin e gjyqtarit që është pavarësia dhe paanësia; secila shkelje e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale; veprimi në kundërshtim me vendimet dhe urdhrat e dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Megjithatë, siç është thënë edhe më lart, Zyra e Prokurorit Disiplinor ngurron që të ofrojë informata mbi statistikat e veprimtarisë së saj në zbatimin e Kodit të Etikës në praktikë.

Në anën tjetër, konflikti i interesave, siç përcaktohet me

Kodin e Procedurës Penale, nuk shmanget nga gjyqtarët. Ka shumë raste kur një gjyqtar përfshihet në rastet e të afërmve të tij/saj, është përfshirë në rast në një mënyrë të cilën Kodi nuk e lejon pjesëmarrjen, etj. Kjo ndodh kryesisht për shkak të neglizhencës së gjyqtarëve, si dhe indiferenca që kryetarët e gjykatave tregojnë ndaj kësaj çështjeje.

ANKESAT NDAJ GJYQTARËVE

Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën e qytetarëve që të ankohen ndaj vendimeve të marra nga gjykatat. Gjithashtu, ajo përcakton që Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, hartimin e rregullave gjyqësore në pajtim me ligjin, angazhimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave [...].

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës përcakton që komisioni disiplinor iniciacioni procedura kundër gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë në këto raste: 1. Dënimi i prerë mbi vepra penale, përveç rasteve të veprave siç parashihet me ligj; 2. Neglizhenca në kryerjen dhe dështimin e kryerjes, apo keqpërdorimi i funksioneve gjyqësore; 3. Dështimi në kryerjen e funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.^{xxxv}

Nuk ka të dhëna mbi atë se në çfarë mase e shfrytëzojnë këtë të drejtë qytetarët.

Zyra e Prokurorit Disiplinor i ka dërguar KGJK-së një numër rastesh, të cilat Këshilli Gjyqësor nuk ka qenë në gjendje t'i absorbojë. Gjithashtu, Raporti i Progresit 2010 nga KE-ja thekson që Këshilli nuk ka qenë në gjendje të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Ai gjithashtu duhet të jetë më proaktiv për të ngritur brengat, si dhe të jetë më vendimtar në çështjet disiplinore.^{xxxvi} Qysh prej vitit 2001, ka pasur 76 ankesa ndaj gjyqtarëve që i janë dërguar KGJK-së për gjykim. Ende mbesin 118 raste të pazgjidhura.

FLAMUR I KUQ

VENDIMET GJYQËSORE TRANSPARENTE DHE TË ARGUMENTUARA

Ligji mbi Gjykatat i garanton gjithë personave qasje të barabartë në gjykata, si dhe ndalon privimin e qasjes së personave ndaj procesit të duhur ligjor apo mbrojtjes së barabartë para ligjit. Ligji gjithashtu përcakton që gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun, përveç nëse nuk përcaktohen ndryshe me ligj.

Megjithatë, një prej aspekteve kryesore të transparencës gjyqësore – qasja publike ndaj gjykatave – dëmtohet në masë serioze për shkak të infrastrukturës së dobët. Një monitorues gjykatash nga shoqëria civile është ankuar për shkak të pamundësisë së qasjes në gjykatare në rastet kur seancat kanë qenë të hapura për publikun.^{xxxvii} Megjithatë, kjo gjë është arsyetuar me mungesën e hapësirës në gjykatare, të cilat nuk ofrojnë kushte të kënaqshme për akomodim të mediave dhe publikut.

Një çështje tjetër e rëndësishme është **botimi i vendimeve gjyqësore** nga gjykatat. Sipas Ligjit mbi Gjykatat, vendimet e Gjykatës Supreme janë dokumente publike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron publikimin e vendimeve të Gjykatës Supreme. Ato vendime, më së paku, duhen botuar në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, por përndryshe i nënshtrohen rregulloreve të Këshillit Gjyqësor. Gjithashtu, edhe vendimet e Gjykatës së Apelit janë dokumente publike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron botimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit.^{xxxviii}

